



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRIŠTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR/03/22

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga pala H.A, ndaj gjyqtares E.U, për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 08.02.2022 nxjerr këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e ushtruar nga pala H.A ndaj gjyqtares E.U, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

Pala H.A me datë 13.01.2022 përmes email-it ka paraqitur ankesë ndaj gjyqtares së Gjykatës Themelore në Prishtinë, E.U, për inicim të procedurës disiplinore. Në të njëjtën ditë, është njoftuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës për pranimin e ankesës nga parashtruesi.

Parashtruesi i ankesës H.A ka paraqitur ankesë ndaj gjyqtares E.U për shkak të pretendimeve se, gjyqtarja e rastit në seancën e datës 10.01.2022, ka insistuar që fëmija i tij, i mituri Y.A ta pranonte fajësinë në lëndën PM.nr.52/2021, dhe se gjyqtarja e rastit – sipas parashtruesit të ankesës – gjatë seancës shfaqte shenja nervoze dhe reagimesh të pakuptimta duke insistuar me çdo kusht, duke bërë presion që i mituri ta pranonte veprën e kryer.

Në lidhje me pretendimet e paraqitësit të ankesës, gjyqtarja e çështjes ka deklaruar se, me datë 10.01.2022 ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor ndaj të miturit Y.A për shkak të dyshimit se ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185, par.2 lidhur me par.1, nënpar. 1.4 të KPRK. Tutje, gjyqtarja ka theksuar se, pasi kanë ardhur të gjitha palët me kohë, është mbajtur seanca gjyqësore ku është lexuar Propozimi nga prokurorja e shtetit, pastaj është ftuar i mituri ta pranonte fajësinë, i mituri ka pranuar se e ka goditur të dëmtuarin me grusht, por jo me mjet të rrezikshëm. Ka shtuar se, përfaqësuesi ligjor i të miturit, H.A ka ndërhyrë duke thënë se jam mjek dhe i di lëndimet trupore me mjet të rrezikshëm. Tutje, përfaqësuesi ligjor i të miturit iu është drejtuar gjyqtares duke i thënë “pse nuk po ia pranonte fajësinë ashtu siç po deklaronte i mituri”, gjyqtarja ka theksuar se, në këtë fazë të procedurës, sipas ligjit ose pranohet në të tërësi fajësia ose mund të mos pranohet, se nuk ka mundësi në këtë fazë të procedurës të pranohet pjesërisht faji, sepse gjykata nuk mund të ndryshoj propozimin e prokurorisë në këtë

fazë të procedurës sepse duhet të shqyrtohen të gjitha provat, atëherë përfaqësuesi ligjor – sipas gjyqtares – ka deklaruar se “unë i bie ligjet”. Gjyqtarja e rastit ka shtuar se, përfaqësuesi ligjor i të miturit nuk i ka kuptuar procedurat dhe ka reaguar kështu duke i bërë presion gjykatës që t’ia pranon fajësinë ashtu siç deklaroi i mituri, e që ka qenë e pamundur në këtë fazë gjykata t’ia pranon fajësinë, e që përfaqësuesi ligjor ka vlerësuar se gjyqtarja po i bën presion të miturit për ta pranuar fajësinë.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, deklarimit të gjyqtares dhe pretendimeve të parashtruesit të ankesës, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtares E.U.

Autoriteti i kësaj Gjykate bazuar në faktet e çështjes ka gjetur se, nuk ka baza të arsyeshme për shkelje disiplinore lidhur me veprimet e gjyqtares E.U, në seancën në të cilën është ankuar pala. Lidhur me pretendimin e palës ankuese se, gjyqtarja e rastit ka bërë presion që fëmija i tij, i mituri Y.A ta pranon fajësinë, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate nuk ka gjetur bazë të mjaftueshme për t’i vërtetuar pretendimet e ushtruesit të ankesës, sepse nga deklarata e gjyqtares dhe nga konstatimet e procesverbalit të seancës gjyqësore, ku të gjitha palët e kanë nënshkruar pa vërejtje, nuk janë vërtetuar pretendimet e ushtruesit të ankesës, për më tepër pala ka pasur avokat, dhe ka mundur të kërkoj që këto pretendime ankimore të evidentohen në procesverbal apo ka mundur që në seancën e radhës të kërkoj plotësimin/përmisimin e procesverbalit, gjë që pala ankuese nuk e ka bërë, për më tepër është obligim ligjor i gjyqtarëve, që pas leximit të aktakuzës apo propozimit prokurorit të shtetit t’ua japin mundësinë të akuzuarve që të deklarohen rreth fajësisë. Gjithashtu duke të theksohet fakti se, gjykata në seancën fillestare nuk mund të bëjë ndryshimin e aktakuzës apo propozimit të prokurorit të shtetit pa shqyrtimin e të gjitha provave dhe fjalës përfundimtare të palëve.

Në dritën e rrethanave të këtij rasti, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate konstaton se, nuk janë vërtetuar pretendimet e palës ankuese për sjellje jo adekuate të gjyqtares, respektivisht për mos trajtim të barabartë të palëve në procedurë, dhe për këtë vlerëson se nuk është shkelur dispozita e nenit 5, par.2, nën-paragrafi 2.1 dhe 2.2 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Andaj, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t’i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të Rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/03/22, me datë 08.02.2022

Albina Shabani Rama

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë